

**FEDERATA E FUTBOLLIT
E KOSOVËS**
Nr. Ref. 104211
Data 22.03.2022
Nënshkrimi [Signature]
Prishtine



Komisioni për mbarvajtjen e procesit deri në datën e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar të FFK-së, i themeluar sipas vendimit të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së të datës 02.03.2022, duke vepruar në përputhje me nenin 34 dhe 50 të Statutit të FFK-së dhe vendimin e Komitetit Ekzekutiv të datës 02.03.2022, pas verifikimit të aplikimeve të kandidatëve për kryetar, verifikimit të delegatëve ligjor që mbështesin kandidatët për t'u zgjedhur Kryetar i FFK-së, si dhe verifikimin e procedurave të tjera statutare deri në datën e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar të FFK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 22.03.2022, pas votimit unanimit mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** aplikimi i Agim Ademi për t'u kandiduar për Kryetar të FFK.
- II. **REFUZOHET** aplikimi i Gramoz Vokri për t'u kandiduar për Kryetar të FFK.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Komiteti Ekzekutiv në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2022 ka nxjerr vendim për themelimin e komisionit të veçantë për mbarvajtjen e procesit deri në datën e mbledhjes së kuvendit të rregullt zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit, verifikimin e delegatëve ligjor që mbështesin kandidatët për t'u zgjedhur Kryetar i FFK-së, dhe verifikimin e procedurave të tjera statutare deri në datën e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar.

Komisioni për mbarvajtjen e procesit deri në datën e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar të FFK-së "**Komisioni**" me datë 18.03.2022 ka mbajtur mbledhjen në të cilën ka shqyrtuar dokumentacionin e të kandiduarve për kryetar të FFK-së, ashtu që nga shqyrtimi i dokumentacionit ka gjetur se z. Agim Ademi ka dorëzuar kërkesën për kandidim ku të njëjtës i ka bashkëngjitur fillimisht 15 nënshkrime të delegatëve që e mbështesin Agim Ademin për kryetar të FFK-së, plan programin për të kandiduar për Kryetar të FFK-së. Më pas kjo kërkesë është mbështetur edhe me nënshkrimet e 29 delegatëve tjerë të Kuvendit të FFK-së, ashtu që gjithsej kandidati Agim Ademi në mbështetje të kandidimit të tij ka deponuar 44 nënshkrime. Pastaj Komisioni ka gjetur se z. Gramoz Vokri ka dorëzuar kërkesën për t'u kandiduar kryetar i FFK-së dhe të njëjtës kërkesë ia ka bashkëngjitur 18 nënshkrime.

Për shkak se nga nënshkrimet e deponuara në mbështetje të kandidatëve kishte rezultuar se janë dorëzuar gjithsej 62 nënshkrime në mbështetje të të dy kandidatëve për Kryetar të FFK-së, ndonëse delegatë të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së janë vetëm 59 delegatë, respektivisht në këtë kuvend janë 58 delegatë për shkak se LRFM nuk ka kandidatë nga Liga e dytë, atëherë në rrethana të tilla Komisioni duke vepruar sipas dispozitave në fuqi, ka bërë verifikimin e fletënënshkrimeve, verifikimin e delegatëve të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, dhe verifikimin e procedurave të tjera statutare dhe normative të FFK-së.

Pas verifikimit të nënshkrimeve në mbështetje të kandidatëve për kryetar të FFK-së, Komisioni ka gjetur se kontestuese kanë qenë nënshkrimet që kanë ardhur nga FC Prishtina, KF Ulpiana 1926 dhe KF Kika.

Lidhur me nënshkrimet që kanë ardhur nga **FC Prishtina**, Komisioni ka konstatuar se janë deponuar katër [4] nënshkrime nga FC Prishtina në mbështetje të Gramoz Vokrii për t'u kandiduar Kryetar i FFK-së. Lidhur me këto nënshkrime Komisioni ka gjetur se në shkresa të lëndës të deponuara me datë 16.03.2022 nga Gramoz Vokrii së bashku me kërkesën e tij janë edhe dy fletënënshkrime, ku në fletënënshkrimin që mbanë datën 05.03.2022 shihet se Rrahman Haradini dhe Artan Osmani nga FC Prishtina me nënshkrimet e tyre kanë mbështetur Gramoz Vokriin, kurse nga fletënënshkrimi që mbanë datën 15.03.2022 i këtij klubi shihet se Fikret Maçastena dhe Rrahman Haradini nga FC Prishtina me nënshkrimet e tyre kanë mbështetur po ashtu Gramoz Vokriin. Meqë Komisioni ka konstatuar se prej një anëtarit të FFK-së janë dërguar gjithsej katër [4] nënshkrime në mbështetje të një kandidati për kryetar të FFK-së, si dhe një person i njëjtë Rrahman Haradini ka deponuar dy nënshkrime për kandidatin Gramoz Vokrii, në rrethana të tilla Komisioni ka kërkuar nga Lidhja Rajonale e Futbollit e Prishtinës “**LRFP**” që e njëjta të jap përgjigje të shkruar se cilët janë delegatët e ligjshëm të FC Prishtinës në Kuvendin e FFK-së dhe se a janë delegatë të ligjshëm dhe të regjistruar zyrtarisht në Kuvendin e FFK-së, personat: Rrahman Haradini, Artan Osmani, dhe Fikret Maçastena. Lidhur me këtë kërkesë të Komisionit, LRFP me datë 21.03.2022 ka dhënë përgjigje të shkruar në të cilën ka konstatuar se *“Në dokumentacionin e LRFP-së që posedon, deri më tani si delegatë kanë të KF Prishtinës kanë qenë të konfirmuar Fikret Maçastena dhe Bajram Sherifi. Për informatën e juaj tani, kohën e fundit na kanë ardh dy shkresa përmes postës elektronike (i) email i datës 02.03.2022 e dërguar nga Rrahman Haradini duke i thirrur si u.d. i kryetarit të klubit ku sqaron se delegat të KF Prishtinës janë Rrahman Haradini dhe Artan Osmani (ne poziten drejtor menagjues), dhe (ii) me datë 14.03.2022 pranohet një email nga Remzi Ejupi si kryetar ku thotë që ndërrohen delegatët e datës 02.03.2022 dhe në vend të Artan Osmani nominon Fikret Maçastena. Menjëher pas pranimi ju kemi shkruar email dhe kemi kërku që të na dokumentojnë në mënyrë të shkruar se këto vendime i ka dhënë organi i rregullt I tyre-kuvendi. Nuk na janë përgjigjur asnjëher. Koment: -Si e cekëm më lartë, duke u bazuar në Statutin e FFK-së, në lidhje me procedurat e ndryshimit të delegatit dhe kush e ndërmerr vendimin për ndryshim të delegatit, përgjigja e LRFP-së është që as njëri dhe as tjetri njoftim për emërim dhe ndryshim të delegatëve të FC Prishtinës nuk janë marrur nga organi kompetent i klubit. Të pakëtën ne në LRFP-së nuk kemi asnjë vendim të kuvendit të FC Prishtina si organ më I lartë, që ka bërë për ndërrimin e delegatit dhe as ndonjë provë që është ndjekur ndonjë procedurë e till ashtu si kërkohet me statut”*. Komisioni pas pranimi të përgjigjes së LRFP-së ka konstatuar se delegatë të ligjshëm dhe regjistruar në Kuvendin e FFK-së nga radhët e FC Prishtina, janë Fikret Maçastena dhe Bajram Sherifi, ndërsa Artan Osmani dhe Rrahman Haradini nuk janë delegatë të ligjshëm dhe të regjistruar në Kuvendin e FFK-së, pasi që njoftimi për ndërrimin e delegatëve respektivisht për caktimin e Artan Osmani dhe Rrahman Hardini si delegatë, nuk është bërë në përputhje me aktet e brendshme dhe statutin, për shkak se as njëri e as tjetri njoftim për emërim dhe ndryshim të delegatëve nuk është marrur nga organi kompetent i FC Prishtina. Komisioni ka ardhur deri tek ky konstatim duke u bazuar në përgjigjen e LRFP-së, dhe duke marrur për bazë nenin 26, paragrafi 4, i Statutit të FFK-së i cili thotë se: *“Çdo ndërrim të delegatit duhet ta bëjë organi i cili e ka zgjedhë, por vetëm për pjesën e mbetur të mandatit dhe brenda kohës së lejuar”*, dhe paragrafi 6 i këtij neni ku thuhet se: *“Delegatët duhet të konfirmohen nga organi që e zgjedh dhe LRFP-ja gjegjëse në afatin e paraparë”*. Ndërrimi dhe emërimi i delegatëve konkret nuk është bërë nga organi që i ka emëruar si delegat të Kuvendit të FFK-së, si dhe emërimi dhe ndërrimi i këtyre delegatëve ashtu siç thuhet në njoftimin e FC Prishtina nuk është bërë në procedurën e kërkuar me statut. Përkundër asaj që LRFP-ja kishte kërkuar konfirmime nga klubi se a ka ndonjë vendim të organit kompetent, këta të fundit nuk i janë përgjigjur asnjëherë. Në këtë drejtim, ndërrimi i këtyre delegatëve nuk është bërë në përputhje me Statutin e FFK-së dhe aktet e brendshme të klubit, andaj në rastin konkret Artan Osmani dhe Rrahim Haradini nuk janë delegatë të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, por që delegatë të ligjshëm dhe të regjistruar janë Fikret Maçastena dhe Bajram Sherifi, të cilët kanë qenë delegatë edhe në mbledhjen e

fundit të Kuvendit të FFK-së. Për shkak se Artan Osmani dhe Rrahman Haradini nuk janë delegatë të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, atëherë Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 18.03.2022 ka marrur vendim që të shpallë nul (të pavlefshëm) nënshkrimin e datës 05.03.2022 të Artan Osmani, dhe të shpallë nul (të pavlefshëm) dy nënshkrimet (dt. 05.03.2022 dhe dt. 15.03.2022) e Rrahman Haradini të deponuara nga Gramoz Vokri me date 16.03.2022. Rrjedhimisht, Komisioni ka konstatuar se nga FC Prishtina është i vlefshëm vetëm nënshkrimi i delegatit Fikret Maçastena, ndërsa delegati i dytë i FC Prishtina z.Bajram Sherifi nuk ka dhënë nënshkrimin për asnjërin kandidat.

Lidhur me nënshkrimet që kanë ardhur nga **KF Ulpiana 1926**, Komisioni ka konstatuar se fillimisht Enver Duriqi dhe Ylli Jashari, delegatë nga KF Ulpiana 1926 përmes letermbështetjes së bashku me nënshkrimet e tyre kanë mbështetur Agim Ademi për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës, të cilat letermbështetese së bashku me nënshkrimet janë deponuar me date 03.03.2022 nga kandidati Agim Ademi. Ndërsa në shkresë të lëndës Komisioni ka gjetur se Bujar Shabani përmes shkresës me numër ref 021/03/2022 e cila mbanë datën 14.03.2022 ka theksuar se *“Në mbledhjen e mbajtur të bordit të klubit të futbollit Ulpiana 1926 nga Lipjani e datës 01.03.2022 është marrur vendim që nga klubi i futbollit Ulpiana 1926 nga Lipjani, të jetë delegat në Kuvendin e FFK-së, të përfaqësoj zëvendës presidenti i Ulpiana 1926 Bujar Shabani”*. Komisioni ka gjetur se e bashkëlidhur me këtë shkresë ka qenë edhe fletë nënshkrimi në mbështetje të kandidatit për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës, sipas të cilit Bujar Shabani i cili thekson se është delegat nga Ulpiana, me nënshkrimin e tij e mbështet Gramoz Vokrin për kryetar të FFK-së, të cilin fletë nënshkrim Gramoz Vokri e ka deponuar me date 16.03.2022. Komisioni ka konstatuar se nga njoftimi për FFK-në i KF Ulpiana 1926 i datës 14.03.2022 drejtuar Federatës së Futbollit të Kosovës thuhet se *“Kryetar i KF Ulpiana 1926 është Abedin Salihu, i cili nuk gjendet në Kosovë për arsye të tij, se ai është ende kryetar i klubit andaj stafi/bordi i klubit nuk kanë mbajtur asnjë takim lidhur me këtë çështje, duke njoftuar se klubi nuk ka ndryshuar dhe nuk ka nxjerrur asgjë deri më tani, duke theksuar se KF Ulpiana 1926 i ka dy delegat të cilët do të marrin pjesë në kuvendin zgjedhor të FFK-së, se këta dy delegatë janë të regjistruar që nga fillimi i sezonës 2021/2022 dhe të njëjtin do të mbesin akoma si delegatë deri në ndonjë vendim tjetër, duke konfirmuar se këta dy delegat janë: Enver Duriqi dhe Ylli Jashari”*. Për shkak të këtyre rrethanave, Komisioni me datë 18.03.2022 me kërkesë i është drejtuar LRFPP, ku ka kërkuar përgjigje të shkruar se cilët janë delegatët e ligjshëm dhe të regjistruar zyrtarisht nga KF Ulpiana 1926 në Kuvendin e FFK-së; se ndërrimi i delegatit të KF Ulpiana 1926 ashtu siç thuhet në shkresën e Bujar Shabani, a është bërë në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative, si dhe aktet e brendshme të klubit; se Bujar Shabani a është delegat i ligjshëm dhe i regjistruar zyrtarisht i Kuvendit të FFK-së nga radha e KF Ulpiana 1926; dhe se ndërrimi i delegatit sipas vendimit me numër ref.021/03/2022 të KF Ulpiana a është bërë nga organi kompetent i klubit KF Ulpiana 1926 dhe se a është ndjekur procedura për ndërrim e pretenduar. Lidhur me këtë kërkesë të Komisionit, LRFPP me datë 21.03.2022 ka dhënë përgjigje të shkruar në të cilën ka konstatuar se: *“Në regjistrat e LRFPP-së të evidentuar nga kuvendi i rregullt i vitit të kaluar e deri më tani si delegatë të ligjshëm të KF Ulpiana 1926 është 1. Ylli Jashari Sekretar dhe pasi kanë hyrë në Superligë si delegat i dytë është emëruar 2. Enver Duriqi-Drejtor. Te LRFPP-ja asnjëherë nuk është ardhur ndonjë kërkesë me prova se kuvendi i KF Ulpiana 1926 ka caktuar z. Bujar Shabani si delegatë të këtij klubi. Për më shumë në evidencat e klubit si përfaqësues i autorizuar është z. Abedin Salihu dhe jo Bujar Shabani si pretendon shkresa e Bujar Shabanit. Kështu që, përgjigja është JO, nuk kemi evidencë ashtu si kërkohet me statut klubit. Për më shumë z. Bujar Shabani nuk ka qenë person e as organ kompetent për të bërë ndryshim të delegatit. Si e cekëm më lartë, duke u bazuar në statutin e FFK-së, në lidhje me procedurat e ndryshimit të delegatit dhe kush e ndërmerr vendimin për ndryshim të delegatit, përgjigja e LRFPP-së është ndonjëherë, po ashtu i njëjti nuk është zgjedh delegatë nga organi kompetent i klubit. Të pakëtën ne në LRFPP-së nuk kemi asnjë vendim të kuvendit të KF Ulpiana 1926 si*

organ më lartë, që ka bërë për ndërrimin e delegatit deb as ndonjë provë që është ndjekur ndonjë procedurë e till ashtu si kërkohet me statut”. Komisioni pas pranimit të përgjigjes së LRFP-së ka konstatuar se delegatë të ligjshëm të KF Ulpiana 1926 në Kuvendin e FFK-së janë Enver Duriqi dhe Ylli Jashari, ndërsa Bujar Shabani fillimisht nuk figuron të jetë përfaqësues i autorizuar në bazë të evidencave të klubit dhe sipas LRFP-së i njeiti nuk ka qenë person e as organ kompetent për të bërë ndryshim të delegatit. Për më tepër, LRFP shton se nuk kanë pranuar asnjë vendim të kuvendit apo ndonje organi të KF Ulpiana 1926 me të cilin është bërë ndërrimi apo emerimi i delegatit. Rrjedhimisht, LRFP-ja ka bërë konstatimin se Bujar Shabani nuk është person kompetent për të bërë caktimin e delegatëve të Kuvendit nga radha e KF Ulpiana 1926 dhe se i njeiti nuk është delegat i ligjshëm i Kuvendit, duke u bazuar edhe në një letër të cilën e kishte pranuar LRFP-ja nga KF Ulpiana 1926 me datë 13 Korrik 2021, në të cilën letër shprehimisht shkruan se Enver Duriqi dhe Ylli Jashari janë delegatët e KF Ulpiana 1926 në Kuvendin e FFK-së, si dhe në letren sqaruese të KF Ulpiana 1926 e datë 14.03.2022 ku rithekson se nuk ka asnjë ndryshim të delegateve dhe delegatëve të ligjshëm janë Enver Duriqi dhe Ylli Jashari. Për shkak të të lartcekurave Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 22.03.2022 ka konstatuar se delegatë të ligjshëm nga KF Ulpiana 1926 në Kuvendin e FFK-së janë Enver Duriqi dhe Ylli Jashari, komisioni në këtë mbledhje ka marrë vendim të shpall nul (të pavlefshëm) nënshkrimin e datës 14.03.2022 të Bujar Shabanit. Ndërsa Komisioni ka konstatuar se të vlefshme janë nënshkrimet e dhëna me datë 03.03.2022 nga delegatët e ligjshëm Enver Duriqi dhe Ylli Jashari nga radhët e KF Ulpiana 1926.

Lidhur me nënshkrimet që kanë ardhur nga **KF Kika**, Komisioni ka konstatuar se Naim Biçkaj, delegat në Kuvendin e FFK-së, nga radhët e KF Kika, fillimisht përmes fletënënshkrimit të deponuar me datë 03.03.2022 ka dhënë nënshkrimin e tij në mbështetje të Agim Ademi për kryetar të FFK-së, kurse përmes fletënënshkrimit të deponuar me 16.03.2022 ka dhënë nënshkrimin e tij në mbështetje të Gramoz Vokri për kryetar të FFK-së. Po ashtu për shkak se delegati Naim Biçkaj fillimisht ka dhënë nënshkrimin e tij në mbështetje të Agim Ademi, kurse më vonë ka dhënë nënshkrimin e tij në mbështetje të Gramoz Vokri, atëherë Komisioni duke u bazuar në Statutin e FFK-së, praktiken e zgjedhjeve të kaluara për kryetar të FFK-së (zgjedhjet e vitit 2008 ku kryetar ishte zgjedhur Fadil Vokri si kandidat i vetëm), dhe vendimin e Komitetit Ekzekutiv të datës 02.03.2022 sipas të cilit parashihet se Komisioni “të shpallë nul nënshkrimet e delegatit në rastin kur delegati ka dhënë dy nënshkrime për të njëjtin kandidat apo/dhe kur delegati ka dhënë nënshkrimin për dy apo më shumë të kandiduar për t’u zgjedhur Kryetar të FFK-së”, ka gjetur se është e jashtëligjshme që një delegat të jap dy nënshkrime për dy kandidatët për kryetar të FFK-së, andaj në mbledhjen e mbajtur me datë 22.03.2022 Komisioni ka marrë vendim që të shpall nul (të pavlefshme) nënshkrimet e delegatit Naim Biçkaj në mbështetje të Agim Ademi dhe Gramoz Vokri. Rrjedhimisht Komisioni ka konstatuar se nga KF Kika nuk ka nënshkrime të vlefshme në mbështetje të kandidatëve për kryetar të FFK-së.

Komisioni në procedurën e mbarvajtjes së procesit dhe të verifikimit ka bërë edhe vlerësimin e kandidatët të propozuar se a i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me nenin 24 dhe 39 të Statutit të FFK-së, për t’u kandiduar për kryetar të FFK-së. Në këtë drejtim Komisioni pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit Agim Ademi ka konstatuar se Agim Ademi është shtetas i Republikës së Kosovës, se i njëjti është i asocuar me njërin nga anëtarët e FFK-së dhe i zgjedhur i FFK-së konkretisht Agim Ademi është kryetar aktual i FFK-së. Po ashtu në bazë të të dhënave personale nga letërnjoftimi Komisioni ka konstatuar se Agim Ademi është në moshën 60 vjeçare, është aktiv në organizatën e Futbollit, nuk është dhe nuk ka qenë i larguar apo suspenduar nga FFK-ja apo anëtarët e saj, poashtu ka konfirmime nga UEFA që dëshmon se Agim ademi nuk ka

dënim, si dhe i njëjti nuk është i dënuar me Aktgjykim të plotëfuqishëm për vepra penale në Kosovë, dhe i njëjti i ka dorëzuar propozimin me dokumentet-nënshkrimet mbështetëse të delegatëve brenda afatit të përcaktuar me statut.

Po ashtu Komisioni pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit Gramoz Vokri ka konstatuar se Gramoz Vokri është shtetas i Republikës së Kosovës, dhe është i moshës 36 vjeçare. Komisioni ka gjetur se Gramoz Vokri nuk ka sjellur dëshmi se është i asocuar me njërin nga anëtarët e FFK-së, nuk ka sjellur dëshmi se është i zgjedhur apo anëtar i emëruar i FFK-së, nuk ka sjellur dëshmi se është aktiv në organizatën e futbollit dhe nuk ka sjellur dëshmi se i njëjti nuk është i dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për vepra penale. Komisioni ka konstatuar po ashtu se duke qenë se Gramoz Vokri nuk është i asocuar apo pjesë e ndonjë anëtari të FFK-së, nuk është i zgjedhur apo anëtar i emëruar i FFK-së, komisioni nuk ka gjetur evidencë se i njëjti të jetë larguar apo suspenduar më herët nga FFK-ja.

Në lidhje me kriteret dhe kushtet që duhet t'i plotësojë një kandidat për t'u zgjedhur kryetar i FFK-së, Komisioni është bazuar në nenin 24, të Statutit të FFK-së, ku parashihet se: "Që një person të kandidohet për organ apo trup statutar të FFK-së, duhet t'i plotësojë këto kushte kumulative: a) që të jetë i asocuar me njërin nga anëtarët e FFK-së; b) të jetë i zgjedhur apo anëtar i emëruar i FFK-së; c) të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; d) të jetë mbi 18 vjeç dhe jo mbi 70 vjeç dhe i aftë për punë; e) të jetë aktiv në organizatën e futbollit; f) të mos jetë i larguar apo i suspenduar më herët nga FFK-ja apo anëtarët e saj; g) të mos jetë i dënuar me Aktgjykim të plotëfuqishëm për vepra penale". Komisioni është bazuar në këtë dispozitë juridike pasi që në rastin konkret organ statutar është edhe Kryetari i FFK-së, andaj kushtet e parapara me këtë nen zbatohen edhe për kandidatin për Kryetar të FFK-së. Në bazë të fakteve të vërtetuara dhe marrë për bazë këtë dispozitë statutare, Komisioni ka ardhur në përfundim se kandidati Agim Ademi i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me nenin 24 të Statutit të FFK-së. Në bazë të fakteve të vërtetuara dhe marrë për bazë këtë dispozitë statutare, Komisioni ka ardhur në përfundim se kandidati Gramoz Vokri nuk i ka plotësuar kushtet si vijon: Gramoz Vokri nuk është i asocuar me asnjërin nga anëtarët e FFK-së, nuk është i zgjedhur apo anëtar i emëruar i FFK-së, nuk është aktiv në organizatën e futbollit, kurse i njëjti me asnjë provë nuk ka vërtetuar se i plotëson këto kritere. Po ashtu Gramoz Vokri nuk ka sjellur as dëshminë nga Gjykata se i njëjti nuk është i dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për vepra penale.

Po ashtu Komisioni pas verifikimit të nënshkrimeve të delegatëve të Kuvendit të FFK-së ka konstatuar se në mbështetje të Agim Ademi për kryetar të FFK-së janë gjithsej 43 nënshkrime të vlefshme të delegatëve të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, kurse vetëm nënshkrimi i delegatit Naim Biçkaj nga KF Kika në Kuvendin e FFK-së, është i pavlefshëm (nul). Në nenin 30, paragrafi 4, dhe nenin 39 të Statutit të FFK-së parashihet se: "*Secili kandidat për Kryetar të FFK-së duhet të jetë i mbështetur me nënshkrimet e së paku 15 delegatëve ligjor të FFK-së*". Marrë për bazë faktet e konstatuara dhe duke u bazuar në këtë dispozitë statutare, Komisioni ka ardhur në përfundim se meqënëse në mbështetje të kandidatit Agim Ademi për Kryetar të FFK-së janë 43 nënshkrime të vlefshme, të cilat janë të afatshme, atëherë ky kandidat e plotëson këtë kusht statutar për të qenë kandidat për Kryetar të FFK.

Komisioni pas verifikimit të nënshkrimeve të delegatëve të Kuvendit të FFK-së ka konstatuar se në mbështetje të Gramoz Vokri për kryetar të FFK-së janë gjithsej 13 nënshkrime të vlefshme të delegatëve të ligjshëm të Kuvendit të FFK-së, kurse të pavlefshëm janë pesë [5] nënshkrime dhe atë: nënshkrimi mbështetës i Naim Biçkaj; dy nënshkrimet mbështetëse të Rrahman Haradini; nënshkrimi mbështetës i Artan Osmanit, dhe nënshkrimi mbështetës i Bujar Shabani. Marrë për bazë faktet e vërtetuara dhe në kuptim të dispozitës statutare nga neni 30, paragrafi 4, 39 paragraf 3 të Statutit të FFK-së, Komisioni ka ardhur në përfundim se meqënëse në mbështetje të kandidatit Gramoz Vokri për Kryetar të FFK-së janë 13 nënshkrime të vlefshme, të cilat nuk janë të mjaftueshme dhe janë të pas afatshme, atëherë ky kandidat nuk i plotëson këto kushte statutare për të qenë kandidat për Kryetar të FFK.

Andaj Komisioni vlerësoi se kandidati Agim Ademi i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret statutare si kandidat për kryetar të FFK-së, të përcaktuara me nenin 24 paragrafi 1, nenin 30 paragrafi 4, dhe nenin 39 të Statutit të FFK-së. Ndërsa, Komisioni vlerësoi se kandidati Gramoz Vokri nuk i plotëson kushtet kumulative nga neni 24, paragrafi 1 i Statutit të FFK-së, dhe nuk e plotëson kushtin statutar nga neni 30, paragrafi 4 dhe neni 39 i Statutit, që i njëjti të jetë i mbështetur me së paku 15 nënshkrime të vlefshme nga delegatët ligjor të Kuvendit të FFK-së dhe ti dorëzojë brenda afatit, dhe kushteve tjera për zgjedhjen e kryetarit sipas këtyre neneve.

Komisioni për kryerjen e mbarvajtjes së procesit deri në datën e mbledhjes së kuvendit të rregullt zgjedhor për zgjedhjen e Kryetarit, verifikimin e delegatëve ligjor që mbështesin kandidatët për t'u zgjedhur Kryetar i FFK-së, verifikimin e procedurave të tjera statutare deri në datën e mbledhjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor për Kryetar, është bazuar në Vendimin e Komitetit Ekzekutiv të datës 02.03.2022 dhe në nenet 34 dhe 50 të Statutit të FFK-së, sipas të cilit këtij komisioni i janë caktuar të drejta dhe përgjegjësi të caktuara, me qëllim që procesi i verifikimit të kandidatëve të propozuar, të dokumenteve përcjellëse (nënshkrimeve të delegatëve) dhe të tjera, të jetë sa më i drejtë, korrekt, transparent dhe në përputhje me kërkesat statutare dhe të akteve normative të FFK-së.

Komisioni kërkoi që parregullsitë e lartcekura në lidhje me nënshkrimet e disa delegatëve, t'i adresoj edhe tek organet përkatëse shtetërore të Kosovës dhe Komisionit Diciplinor të FFK-së.

Po ashtu, Komisioni sqaron se ky vendim do t'i dërgohet Komitetit Ekzekutiv dhe Kuvendit të FFK-së, për aprovim. Me këtë vendim të Komisionit, do të njoftohen UEFA, FIFA dhe MKRS-ja.

Prandaj duke u bazuar në të cekurat si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI PËR MBARVAJTJEN E PROCESIT DERI NË DATËN E Mbledhjes së KUVENDIT TË RREGULLT ZGJEDHOR PËR KRYETAR TË FFK-SË

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur mund të atakojë këtë vendim së bashku me vendimin e Kuvendit të FFK-së;

Prishtinë, datë 22.03.2022